

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë
Përmes:	Adrijana Hodžić, Ministre e Administrimit të Pushtetit Lokal Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme
Nga:	Venera Çerkini, U.D e Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL Datë: 06/05/2019 Nr.020-491
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:


Vendimi 01Nr. 104/02-12845/19, për bashkëpunim ndër komunal, me Komunën e Hanit të Elezit.

I miratuar më datë: 30.04.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.05.2019

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za:	Besim Ilazi, gradonačelnik Opštine Kačanik Kemal Mërseli, predsedavajući Skupštine opštine Kačanik	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinica za administraciju dokumenata u u opštini Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština /MALS	
Preko:	Adrijana Hodžić, ministarka MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Venera Çerkini, v.d. rukovodioca Pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS	Datum, 06.05.2019. Br. 020/491
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kamenica.	
Vrsta akata:	Odluka	

Uvaženi gradonačelnice,
Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Pravno odlejenje i monitorisanje opština MALS-a, primio je za obavezno razmatranje zakonitosti akata opština kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01br. 104/02-12845/19, za međuopštinsku saradnju sa opštinom Elez Han.
Usvojena dana, 30.04.2019. godine
Predložena za razmatranje u MALS-u dana, 03.05.2019. godine

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenih akata opštine, procenjuje da su opštinski akti u **saglasnosti za odredbama zakonodavstva na snazi.**

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

REPUBLIC OF KOSOVO GOVERNMENT OF KOSOVO			
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministritshë Lokale Samouprave i Administracije Ministry of Local Government Administration			
Data Datum		05.02.2019	
Titulli i dokumentit			
Shkronja	Titulli i Dokumentit	Shtojca	Shënim
-VF-	020-	491	



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

01 Nr. 104/02-12848/19
Kaçanik, 30.04.2019

Në pajtim me nenin 12.2 (d) lidhur me nenin nenit 40.2 (j) të Ligjit Nr. 03/1-40 -Për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/4 Qershor 2008), në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 -Për Bashkëpunim Ndër Komunal, Kuvendi i Komunës Kaçanik, me datë 30 Prill 2019, mori këtë:

VFNDIM PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL MË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

1. Me këtë Vendim, Miratohet Nisma e Kryetarit të Komunës së Kaçanikut, për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal për realizimin e Projektit për rihapjen, zgjerimin dhe rregullimin e rrugës, nga Ishati Gorancë deri në ishatin Kotlinë.
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunat si në vijim:
 - 2.1. Komuna e Kaçanikut, dhe
 - 2.2. Komuna e Hanit të Elezit.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Kaçanikut, për të filluar konsultimet me Komunën e Hanit të Elezit, për përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për bashkëpunim ndër komunal, për projektin e përcaktuar si në pikën 1. të këtij vendimi.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në Ueb faqen e Komunës së Kaçanikut.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesët, Kryetari i Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPI, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Merseli



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kačanik

01/Nr. 104/02-12845/19
Kačanik, 30.04.2019

Na osnovu člana 12.2 (d) u vezi sa članom 40.2 (j) Zakona br. 03 / L-40 - O lokalnoj samoupravi (Službeni list Republike Kosovo br. 28/4-jun 2008), shodno člana 7 Zakona br. 04 / L-010 - O opštinskoj meduopštinskoj saradnji, Skupština opštine Kačanik je 30. aprila 2019. godine izdala sledeće:

ODLUKA
ZA OPŠTINSKU SARADNJU SA OPŠTINOM DJ. JANKOVIĆ

1. Ovom Odlukom odobrena je Inicijativa Predsednik Opštine Kačanika da ude u meduopštinsku saradnju za realizaciju Projekta za ponovno otvaranje, proširenje i regulaciju puta od sela Gorince do sela Kotlina.
2. Meduopštinska saradnja će se razvijati sa opštinama na sledeći način:
 - 2.1. Opština Kačanik, i
 - 2.2. Opština Dj. Janković
3. Predsednik opštine Kačanik je ovlašćen da inicira konsultacije sa Opštinom Dj. Jankovića za pripremu nacrtu Sporazuma o meduopštinskoj saradnji za projekat definisan u tački 1 ove odluke.
4. Ova Odluka stupa na snagu 15 dana nakon registracije u kancelariji protokola Ministarstva Administrativne Lokalne Samouprave i nakon njenog objavljivanja na internet stranici Opštine Kačanik.
5. Za sprovođenje ove odluke brinete se za Predsednik opštine

Ovom odlukom se obavestavaju: MALL, Predsednik Opštine, Direkcija javnih službi i firmih službi i Arhiv.

Predsedavajući Skupštine
Kemal Murçeti



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndërkomunal, Kryetari i Komunës paraqet kërkesë për miratimin

NISMËN
PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT
NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE NË VISET RURALE

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet ndërmjet komunave si në vijim:

- Komunës së Kaçanikut
- Komunës së Hanit të Elezit.

2. Bashkëpunimi ndërkomunal do të bëhet në fushën e infrastrukturës rrugore në territorin e Kaçanikut dhe Hanit të Elezit, ndërmjet zonave kadastrale të dy komunave sipas certifikatave të pronave dhe do të bëhet zgjerimi, rregullimi dhe lidhja e dy rrugëve, gjegjësisht Ishatit Kothinë dhe Gorancë

Arsyetim

Me qëllim që të bëhet lidhja dhe qarkullimi i fshatrave nëpërmjet tyre, të dy komunat shprehin gatishmëri që të plotësohet infrastruktura rrugore nëpërmjet fshatrave Kothinë dhe Gorancë. Kjo do t'i mundësoj fshatrave një qasje shumë më të favorshme në pronat e tyre. Me anë të katër marrëveshjeve për bashkëpunim ndërkomunal mundësohet aplikimi me projekt propozim për realizim nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL)

02/nr.109 / 26.04.2019
Komuna e Kaçanikut
Datë:26.04.2019

z. Besim Ilazi
Kryetar i Komunës





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK

26.04.2019

NUMRI: 01-104/02-1283
SERIJA: 71



Kuvendi i Komunës
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

LISTË DISTRIBUIM/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

DATE/A:	26. 04. 2019
PËR/ZËTO:	Zyrës së Kuvendit Komunal Kemajl MËRSEJL, kryesues i Kuvendit Komunal
PËRMES/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	Besim ILAZI, kryetar i komunës
TEMA/SUBJEKTI/SUBJECT:	Nisma dhe Propozim-Vendim për Miratimin e Nismës për bashkëpunim ndërkomunal me komunën e Hanit të Elezit

Të nderuar,

Me anë të kësaj shkrese zyrtare ju dorëzojmë Nismën dhe Propozim-Vendimin për Miratimin e Nismës për bashkëpunim ndërkomunal me komunën e Hanit të Elezit.

Ministria e Pushtetit Lokal ka shpallur thirrje për aplikim për komunat të cilat lidhin marrëveshje bashkëpunimi në mes tyre. Në suaza të kësaj komuna jone në bashkëpunim me komunën e Hanit të Elezit janë dakorduar që të nisin negociata lidhur me rihapjen, zgjerimin dhe rregullimin e rrugës që lidh dy fshatrat Goracë të Hanit të Elezit dhe Kofline të Komunës së Kaçanikut që do të mundësonin një qasje shumë të favorshme në lëvizjen e qytetarëve që gravitojnë në këto zona.

Te bashkëngjitur kemi Nismën për bashkëpunim dhe Propozim-Vendimin për miratimin e Nismës së bashkëpunimit.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipality of Kaçanik

Në pajtim me nenin 12, pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndërkomunal, Kryetari i komunës së Kaçanikut propozon:

VENDIM
MBI BASHKËPUNIMIN NDËR KOMUNAL MË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

1. Me këtë Vendim miratohet nisima e kryetarit të komunës së Kaçanikut për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal për realizimin e propozim projektit për rihapjen, zgjerimin dhe rregullimin e rrugës nga fshati Gorancë deri në fshatin Kollinë.
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me komunat si në vijim:
-Komuna e Kaçanikut dhe
-komuna e Hanit të Elezit
3. Autorizohet kryetari i komunës për të filluar konsultimet me komunën e Hanit të Elezit për përgatitjen e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit lokal si dhe pas publikimit në ueb faqen e komunës së Kaçanikut.

01 nr. 261/06.12.2019
Komuna e Kaçanikut

Kryetari i komunës Kaçanikut
Besmir ILAZI

Gëzim Sahiti

From: Lumnije Demi
Sent: 2019-05-06 10:38 PD
To: Gëzim Sahiti
Cc: Xhevat Tafa; Besa Shala; Trim Berisha
Subject: FW: Kerkesw per konsultim per vendim tw bashkpunimit nderkomunal
Attachments: Vendimi, bashkepunimi nderkomunal.pdf

I nderuar Gëzim,

Vendimi i Komunës së KK të Kaçanikut është konform Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Me respekt,
Lumnije Demi

From: Gëzim Sahiti
Sent: Monday, May 06, 2019 10:17 AM
To: Lumnije Demi <Lumnije.Demi@rks-gov.net>; Besa Shala <Besa.Shala@rks-gov.net>
Cc: Xhevat Tafa <Xhevat.Tafa@rks-gov.net>
Subject: Kerkesw per konsultim per vendim tw bashkpunimit nderkomunal

Pershendetje

Po ju percjellë Vendim për miratimin e projekteve për bashkëpunim ndërkomunal) te miratuar nga KK Kaçanik, ju lutem qe ju si Divizion perkatës të jepni mendimin se a është ne rregull dhe a l plotwson kushtet ky vendim pwr ta konfirmuar ligjshmerinë

Me Respekt!
Gëzim Sahiti
Zyrtar i lartë për Monitorim të Komunave
Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
10 000 Prishtinë
Ndërtesa Qeveritare ish "Rilindja" Kati XI
Telefoni: 038/200/ 35-574
Mobil: 049/ 666-411
044/393-313